



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2021:120022

Datë: 12.03.2024

Numri i dokumentit: 05440585

E.nr.9/23

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, duke vendosur në lëndën e përmbartimit të kreditorit I.E. nga Ferizaj, të cilin e përfaqëson av Zejnije Bega nga Ferizaj, kundër debitorit Komuna e Ferizajt – Drejtoria e Arsimit, për pagesën e licencimit dhe shpenzimet e procedurës, më datë 12.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

PËRFUNDON procedura përmbartimore në lëndën E.nr.9/23, për shkak të përmbushjes së kërkesës së kreditorit.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Ferizaj, me aktvendimin E.nr.9/23, të datës 18.01.2023, e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit kundër debitorit Komuna e Ferizajt – Drejtoria e Arsimit, për pagesën e licencimit dhe shpenzimeve të procedurës, në bazë të pajtimit gjyqësor 2021:120022, të datës 10.10.2022.

Meqenëse aktvendimi mbi lejimin e përmbartimit është bërë i formës së prerë dhe i ekzekutueshëm, gjykata me aktvendimet e datës 14.02.2023 dhe 12.03.2024, e ka urdhëruar Thesarin e Kosovës pranë Ministrisë së Financave, Punës dhe të Transfereve, që nga llogaria e debitorit ta transferoj shumën e përgjithshme të mjeteve prej 2,137.68 euro dhe shumën e mjeteve prej 390 euro, në llogarinë e të autorizuarit të kreditorit.

Meqenëse kreditori e ka realizuar kërkesën e tij, Gjykata konstatoj se janë përmbushur kushtet ligjore nga neni 66, par 4, të LPP-së dhe vendosi që ta përfundoj procedurën përmbartimore në këtë çështje juridike përmbartimore.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ

E.nr.9/23, më datë 12.03.2024

GJYQTARI

Faton Ajvazi